



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Nr. 415/15 Prot.

Tiranë, më 15.01.2018



MIRATOHET

MINISTRI

LINDITA NIKOLLA

PROGRAM ORIENTUES PËR MATURËN SHTETËRORE

LËNDA: GJUHË ANGLEZE
Provim i detyruar (Niveli B1)

Viti shkollor 2017 - 2018

Tiranë, janar 2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

PROGRAM ORIENTUES PËR MATURËN SHTETËRORE

LËNDA: GJUHË ANGLEZE
PROVIM I DETYRUAR (niveli B1)

Viti shkollor 2017 – 2018

1. SYNIMET E PROGRAMIT

Hartimi i këtij programi orientues është bazuar tërësisht në programet e gjuhës angleze, të cilat përcaktojnë njohuritë dhe shprehjet e domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale.

Programi orientues për përgatitjen dhe realizimin e provimit të Maturës Shtetërore për gjuhën angleze si provim i detyruar, është realizuar si sintezë e njohurive dhe shprehjeve të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë, si në aspektin tematik ashtu edhe në aspektin gjuhësor (gramatikor, leksikor) dhe funksional.

Programi Orientues është hartuar duke pasur parasysh nevojat e nxënësve, zhvillimet e tyre individuale duke u dhënë mundësi për sukses në atë çka i pret.

Ky program synon:

- të ndihmojë nxënësin maturant në përgatitjen e tij për provimin e gjuhës angleze si provim i detyruar në nivelin gjuhësor B1, bazuar në nivelet gjuhësore të përcaktuara në Shkallën globale të Kuadrit Evropian të Referencave për Gjuhët;
- të ndihmojë mësuesin e lëndës në punën e tij për zbatimin e programit dhe për t'u dhënë orientimet e duhura nxënësve për mënyrën se si të mbështeten në këtë program dhe çfarë duhet të dinë ata për të realizuar me sukses këtë provim përmbyllës të dijeve të tyre në lëndën e gjuhës së huaj;
- orientimin e vlerësimit që do të përfshijë 2 aftësi kryesore (nga katër aftësi që ka gjuha e huaj “të lexuarit dhe të kuptuarit” dhe “të shprehurit me shkrim”), si dhe konceptet gjuhësore, gramatikore dhe funksionale të domosdoshëm për nivelin B1;
- të japë orientime për specialistët që merren me hartimin e testeve të Maturës Shtetërore për gjuhën angleze si provim i detyruar.

2. UDHËZIMET PRAKTIKE MBI PËRDORIMIN E PROGRAMIT

Për përdorimin e këtij programi mësuesi duhet të ketë parasysh specifikën e gjuhës së huaj, ku nxënësi në provim do të përballet me situata të reja ose me pjesë të reja leximi por tematika, gramatika dhe funksionet gjuhësore do të jenë po ato që ka studiuar ndër vite.

Kur flitet për tematikën kryesore në program nxënësit duhet që të kenë njohuri për temat që janë të përfshira në program (*Sports and Entertainments, Travel Time, Environmental Issues, Modern Living, education, Personal and Social Life etc.*)

Përsa i përket përdorimit të gjuhës, mësuesi duhet t'i përgatisë nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin ushtrime mbi aspektet kryesore gramatikore dhe leksikore që ata kanë trajtuar gjatë viteve të shkollës së mesme. (*passive voice, conditionals, reported speech, verb tenses,*

adverbs and adjectives comparisons, prepositions, connectors, countable and uncountable nouns; vocabulary related to entertainments, hobbies, food, celebrations, holiday destinations, types of travel, weather conditions, environmental issues, science, technology, fashion, etc) duke dalë nga konteksti i mësimëve ku këto probleme trajtohen. Mësuesi duhet t'i vërë theksin anës praktike të zgjidhjes së ushtrimeve, duke i trajtuar këto ushtrime në forma të ndryshme, herë me tipe ushtrimesh me alternativa, e herë tipe ushtrimesh të hapura, ku më të spikaturat janë *gap-fill, sentence transformation, matching*, etj.

Funksionet gjuhësore duhet të trajtohen në mënyrë sa më të larmishme duke përdorur situata nga të gjitha fushat e jetës por duke ruajtur formatet dhe shprehjet që jepen në tekstet mësimore. Nxënësi duhet të jetë i përgatitur kryesisht për këto nocione gjuhësore:

- *Expressing interests*
- *Giving personal information*
- *Recommending places*
- *Making suggestions (proposals, comments) on simple issues*
- *Suggesting and reaching a decision*
- *Expressing similarities and differences*
- *Expressing likes and dislikes*
- *Making and responding to invitations*
- *Asking and answering personal questions*
- *Complaining and apologizing*

Përsa i përket të shkruarit mësuesi duhet të ushtrojë nxënësit e tij që të dinë të organizojnë forma të ndryshme të të shkruarit si:

- *email to a friend about a travel experience;*
- *a short review of a film, story, book, etc.;*
- *Letters or emails of recommendation;*
- *Narrative or descriptive letters or emails;*
- *Describing of a movie, concert, festival;*
- *A summary of a text, story, etc.*

3. AFTËSITË DHE NJOHJET QË DUHET TË ZOTËROJË NXËNËSI MATURANT PËR TË QENË I PËRGATITUR PËR PROVIMIN E MATURËS ME DETYRIM NË GJUHËN ANGLEZE NË NIVELIN B1

Nxënësi që do t'i ushtrohet provimit të maturës me detyrim, në gjuhën angleze duhet të demonstrojë **aftësitë dhe njohuritë** e tij për çka ka marrë dhe përfituar nga të nxënit në këtë lëndë gjatë viteve të shkollës së mesme. Përshkrimin e kompetencave dhe njohurive po i

paraqesim në gjuhën angleze pasi nxënësi është njohur me to në Portofolin Evropian të Gjuhëve ku jepet përshkrimi për çdo nivel gjuhësor.

Reading and Comprehension

Students at level B1 can understand texts that consist mainly of high frequency everyday or job-related language. They can understand the description of events, feelings and wishes in personal letters.

- *They can read straightforward factual texts on subjects related to their field of interest with a satisfactory level of comprehension.*
- *They can understand the description of events, feelings and wishes in personal letters well enough to correspond regularly.*
- *They can find and understand relevant information in everyday material, such as letters, brochures and short official documents.*
- *They can recognize significant points in straightforward newspaper articles on familiar subjects.*
- *They can identify the main conclusions in clearly signaled argumentative texts.*
- *They can search one long or several short texts to locate specific information they need to help them complete a task.*
- *They can recognize significant points in straightforward newspaper articles on familiar subjects and can identify the main conclusions in clearly-written argumentative texts.*
- *They can recognize the general line of argument in a text but not necessarily in detail.*
- *They can understand clearly-written straightforward instructions for a piece of equipment.*

Writing

Students at level B1 can write simple connected text on topics which are familiar or of personal interest. They can write personal letters describing experiences and impressions.

- *They can write straightforward connected texts on a range of familiar subjects within their field of interest, by linking a series of shorter discrete elements into a linear sequence.*
- *They can write straightforward, detailed descriptions on a range of familiar subjects within their field of interest.*
- *They can write accounts of experiences, describing feelings and reactions in simple connected texts.*
- *They can write a description of an event, e recent trip- real or imagined.*
- *They can narrate a story.*

- *They can summarize report and give their opinion about accumulated factual information on familiar routine and non-routine matters within their field with some confidence.*
- *They can write short, simple essays on topics of interest.*
- *They can write personal letters describing experiences, feelings and events in some detail.*
- *They can write personal letters giving news and expressing thoughts about abstract or cultural topics such as music, films.*

Use of English

a) Functions/ notions

- *Describing places*
- *Describing past experiences and storytelling*
- *Describing feelings, emotions, attitudes*
- *Expressing opinions*
- *Expressing agreement/ disagreement*
- *Talking about films and books*

b) Verb forms

- *5 W-s-h- and Yes/No Questions in present /past*
- *Complex question tags*
- *Past continuous*
- *Used to*
- *Would expressing habits in the past*
- *Past perfect*
- *Future time (will & going to)*
- *Future continuous*
- *Present perfect*
- *Present perfect vs. past simple*
- *Present perfect continuous*
- *Conditionals*
- *Zero, first and second conditional*
- *Phrasal Verbs*
- *Passives*
- *Simple passive*
- *Reported speech (range of tenses)*
- *Modals: Possibility*

- *Might, may, will, probably*
- *Must/can't (deduction)*
- *Modals: Obligation & Necessity*
- *Must/have to*
- *Ought to*
- *Need to*
- *Modals: Past*
- *Should have, might have/etc.*
- *Articles with countable and uncountable nouns*
- *Determiners*
- *Broad range (e.g. all the, most, both)*
- *Collocation of adjectives*
- *Adverbial phrases of time, place and frequency including word order*
- *Adjectives vs. adverbs*
- *Adverbial phrases of degree/extent, probability*
- *Comparative and superlative form of adverbs*
- *Broader range of intensifiers*

c) Vocabulary

- *Town, shops and shopping*
- *Travel and services vocabulary*
- *Contrasting opinions (on the one hand...)*
- *Collocation*
- *Colloquial language*
- *education*

4. STRUKTURA E PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE ME DETYRIM, GJUHA ANGLEZE NË NIVELIN B1

Testi i gjuhës angleze me detyrim në nivelin gjuhësor B1 do të jetë i ndarë në 3 seksione ku testohen:

- *Të kuptuarit e një pjesë letrare ose jo letrare.*
- *Përdorimi i gjuhës që përfshin aspektet më të rëndësishme gramatikore dhe leksikore trajtuar në vitet e shkollës së mesme.*
- *Të shkruarit.*

Pesha që zë çdo seksion në provim	Seksioni 1 <i>Reading Comprehension</i>	Seksioni 2 <i>Use of English</i>	Seksioni 3 <i>Writing</i>
Në %	40%	40%	20%
Në pikë	20 pikë	20 pikë	10 pikë
Niveli 1	10 pikë	10 pikë	
Niveli 2	10 pikë	10 pikë	
Niveli 3			10 pikë

Nxënësi me *Nivelin 1, 2, 3*, do të duhet të nënkuptojë që janë pyetje të nivelit të lehtë, mesatar dhe të vështirë.

5. OBJEKTIVAT E VLERËSIMIT TË NDARA DHE TË DETAJUARA SAKTËSISHT SIPAS TRI NIVELEVE

Nr.	Seksionet	Pikët	Pesha
1	<i>Të lexuarit dhe të kuptuarit</i>	<i>20 pikë</i>	<i>40%</i>
	- Gjetja e informacionit të duhur nga teksti i dhënë (Niv. 1)	3 pikë	
	- Reflektimi mbi përmbajtjen e një fragmenti dhe nxjerrja e informacionit faktik prej tij (Niv. 1)	3 pikë	
	- Perifrazimi i një fraze ose shprehjeje shkëputur nga teksti (Niv. 2)	3 pikë	
	- Nxjerrja e një kuptimi të përgjithshëm dhe e moralit të pjesës, ose idesë qendrore shprehur në gjuhë të thjeshtë (Niv. 3)	2 pikë	
	- Gjetja e elementëve që justifikojnë përgjigjen e dhënë (Niv. 2)	3 pikë	
	- Plotësimi i ushtrimeve leksikore rreth tekstit (Niv. 1)	3 pikë	
	- Gjetja e fjalëve referuese (Niv. 2)	3 pikë	

2	<i>Gramatika</i> <ul style="list-style-type: none"> - Kohët e foljeve (Niv. 1) - Shkallët e mbiemrave, (Niv. 1) - Lidhëzat, (Niv. 1) - Përemrat lidhorë të thjeshtë, (Niv. 1) - Parafjalët (Niv. 2) - Shprehjet me parafjalë, (Niv. 2) - Format pësore, (Niv. 2) - Ligjërata e zhdrejtë, (Niveli 3) - Foljet frazale, (Niveli 2) - Kushtoret 0 dhe 1(Niveli 2) 	<i>10 pikë</i> 1 pikë 1 pikë 1 pikë 1 pikë 1 pikë 1 pikë 1 pikë 1 pikë 1 pikë	20%
3	<i>Fjalori</i> <ul style="list-style-type: none"> - Mënyrat e fjalëformimit me parashtesë (Niveli 2) - Mënyrat e fjalëformimit me prapashtesë (Niveli 1) - Grupet sinonimike (Niveli 2) - Shndërrime fjalish duke ruajtur kuptimin fillestar (Niveli 2) 	<i>10 pikë</i> 2 pikë 3 pikë 3 pikë 2 pikë	20%
4	<i>Të shkruarit</i> <ul style="list-style-type: none"> - Realizimi i temës (Përmbajtja) - Organizimi - Saktësia në gramatikë - Fjalori i përdorur - Respektimi i rregullave të shkrimit (shenjat e pikësimit, strukturat e ndërtimit të frazave dhe fjaltive, shkronjat kapitale etj.) 	<i>10 pikë</i> 2 pikë 2 pikë 2 pikë 2 pikë 2 pikë	20%
<i>Totali</i>		<i>50 pikë</i>	100%

6. TIPA USHTRIMESH QË NXËNËSI DUHET TË PUNOJË PËR TË QENË I PËRGATITUR PËR PROVIMIN E MATURËS ME DETYRIM NË GJUHËN ANGLEZE

a) Tipat e ushtrimeve që mund të jepen në Reading Comprehension:

- *True or False*
- *Multiple Choice* (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 ose 5 alternativat e dhëna)
- *Arrangements of paragraphs* (vendosja e paragrafëve sipas rendit të duhur në renditjen e ngjarjeve)

- *Sentence or phrase completion* (plotësimi i kuptimit të një fjalie ose fraze në një tekst të caktuar mbi një temë të caktuar)
- *Open answers* (përgjigje të hapura ku nxënësi shpreh mendimin dhe vlerësimin e tij rreth një çështjeje ose pyetjeje të caktuar rreth tekstit)
- *Short answers* (përgjigje të shkurtra, të dhëna me fraza ose fjali të shkurtra)
- *Matching* (Bashkimi i një pjese teksti me një pjesë tjetër që mungon dhe e plotëson kuptimin e tij në tërësi)

b) Tipat e ushtrimeve që mund të jepen në përdorimin e gjuhës:

Tipet e ushtrimeve që do të përdoren në provimin me detyrim në gjuhën angleze mund të jenë të tipeve si më poshtë:

- *Multiple Choice* (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 ose 5 alternativat e dhëna);

Example:

She hates -----.

A) washing up

B) to wash up

C) wash up

D) to washing up

- *Gap-fill* (plotësimi i fjalisë me gjetjen e një fjalie ose fraze të duhur me të cilën ka kuptim fjalia ose fraza);

Example:

1) Anne ----- (repair) her bike next week.

2) We ----- (do) the washing by 8 o'clock.

Example:

1) I always take care ____ my little brother when my mother is ____ .

- *Sentence Transformation* (shndërrim fjalish duke e strukturuar ndyshe, por duke i ruajtur kuptimin fillestar);

Example:

Despite knowing the area, I got lost.

Although

I got lost _____ the area well.

- *Word Formation* exercises (ushtrime mbi mënyrat e fjalëformimit)

Example:

Students` _____ in school activities is very important. PARTICIPATE

c) **Në temën me shkrim**, nxënësi duhet të jetë i aftë të prezantohet me punë të tilla si:

- Email formal ose jo formal
- Letër formale ose jo formale
- Përshkrim
- Ritregim
- Përmbledhje
- Ese përshkruese